



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Hamz ( Smajl ) Lladrovcit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale, nr. 00931-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00931-0, Zona kadastrale, Matičan, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues "Zona Qendër", i miratuar me Vendimin, nr. 01 nr. 035-186861, dt. 02.10.2013, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale, nr. 00210-0, sipërfaqe prej 5863m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00210-0, dhe parcela 00206-1, sip.422 m<sup>2</sup> Certifikata e pronësisë, nr. P- 71914075-00206-1, Zona kadastrale Çagllavicë, në pronësi të Hamz ( Smajl ) Lladrovcit, me destinim interes publik, rrugë, sipas Plani rregullues "Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin, nr. 01nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për arsyet se prona e lartcekur shfrytëzohet për interes publik, dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, andaj për t'u shmangur pasojat e larta financiare që mund të vijën nga proceset gjyqësore, është propozuar që prona e lartcekur të këmbehet me pronën komunale.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

## Arsyetim

1. Pronari i pronës private, në bazë të kërkesës nr. 13-464/01-106735/2021, ka kërkuar që të kompensohet për pronën private e cila shfrytëzohet për interes publik, gjegjësisht është parcela nr. 00210-0, sip. 5863 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00210-0, dhe parcela 00206-1, sip. 422 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00206-1, Zona kadastrale, Çagllavicë, në pronësi të Hamz (Smajl) Lladrovci, me destinim interes publik, rrugë, sipas Planit rregullues “Zona Perëndim”, 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.
2. Propozimi për inicimin e këmbimit të pronës komunale me pronën private të cekur në pikën II, është bërë për arsyet se prona e lartcekur shfrytëzohet për interes publik, dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, andaj për tu shmangur pasojat e larta financiare që mund të vijnë nga proceset gjygjësore, është propozuar që prona e lartcekur të këmbëhet me pronën komunale, gjegjësisht me pjesën e parcelës nr. 00931-0, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00931-0, Zona kadastrale, Matiçan, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues “Zona Qendër”, 01 nr. 035-186861, dt. 02.10.2013.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/03-112298/21, më 16.06.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta

